**VENDIM**
**Nr. 113, datë 22.09.2015**

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "C & S ENERGY" SHPK NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC "RAPUN 3 & 4" ME FUQI TË INSTALUAR 8857 KW**

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa "a" dhe 110, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të neneve 4, pika 1, germa "a"; 5, pika 1 germa "a"; 10, pika 3 të rregullores "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 108, datë 9.9.2008 dhe nenit 18, pika 1 germa "a" e "Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 22.9.2015, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "C & S Energy" sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut dhe të Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie nga HEC "Rapun 3 & 4",

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "C & S Energy" sh.p.k. plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik-ekonomik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.4 dhe 4.1.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për mungesën e dokumentacionit, që ka të bëjë me:

- dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2);
- dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3);
- dokumentacioni teknik-ekonomik (neni 9 pika 4.1.3),

do të njoftohet subjekti që në bazë të rregullores "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", neni 10, pika 10 dhe neni 11, pika 1, t'i paraqesë këto në ERE, brenda afateve të përcaktuara.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për licencimin e shoqërisë "C & S Energy" sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Rapuni 3 & 4", me fuqi të instaluar 8857 kW.
2. Drejtoria e Licencimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
**Petrit Ahmeti**